



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	12.10.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHC	6525	2023	113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.1184/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1184/2023 të datës 19.09.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë rr.

“ kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “Shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 12.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.1184/2023 i datës 19.09.2023 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Nëpunësja civile e punësuar në pozitën “Inspektore për Sigurimin e Aviacionit Civil”, në kuadër të Departamentit për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme, sipas Ndryshimit të Akt Emërimit me numër protokollit 575 të datës 26.08.2019, ankuesja me datë 19.09.2023 me numër protokollit 6158/2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të mos përgjigjes nga organi i punësimit për mos shqyrtimin e ankesës së datës 04.08.2023 me nr. protokollit 873/23 lidhur me koeficientin e pagës, cenim të dispozitave esenciale të procedurës administrative dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.09.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Këshilli më datë 28.09.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. protokollin 6158/2023 të datës 19.09.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë me numër protokollin 1409-12 i datës 02.08.2023; Divizioni për sigurim të aviacionit përshkrimi i detyrave të punës; Akt Emërim i K.G. me numër Nr. ref. DSP-01/13 i datës 24.06.2013; Ndryshim i Aktit të Emërimit i A.K.B. me numër protokollin 575 i datës 26.08.2019; Kërkesë me numër protokollin 1604-4 i datës 05.09.2023; Përgjigje me numër protokollin 996-2 i datës 14.09.2023; Përshkrimi i detyrave të punës; E-mail nga ankesa.kpmshck@rksgov.net për A.K. i datës 19.09.2023; E-mail nga A.K. për ankesa.kpmshck@rksgov.net i datës 19.09.2023; E-mail nga A.K. për ankesa.kpmshck@rksgov.net i datës 19.09.2023; E-mail nga A.K. për ankesa.kpmshck@rksgov.net i datës 21.09.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 22.09.2023; Përgjigje në ankesë e datës 28.09.2023; Përshkrimi i detyrave të punës; Kërkesë për korrigjimin e gabimeve të ekuivalentimit nga DSAC mars 2023 me numër protokollin 320-12 i datës 08.03.2023; E-mail nga A.G. për info.dmzp i datës 15.03.2023; Kërkesë për ekuivalentimin e koeficienteve me numër protokollin 332 i datës 15.03.2023; Kërkesë me numër protokollin 909-3 i datës 29.05.2023; E-mail nga A.G. për info.dmzp i datës 01.06.2023; E-mail nga N.B. për A.G. etj. i datës 30.05.2023; E-mail nga A.G. për Sh.A. i datës 23.06.2023; E-mail nga Sh.A. për A.G. i datës 01.06.2023; E-mail nga A.G. për Sh.A. i datës 26.06.2023; E-mail nga Sh.A. për A.G. i datës 23.06.2023; E-mail nga Sh.A. për A.G. etj. i datës 13.09.2023; E-mail nga A.G. për info.dmzp etj. i datës 11.09.2023; E-mail nga A.G. për Sh.A. i datës 14.09.2023; E-mail nga Sh.A. për A.G. etj. i datës 13.09.2023; Lista e pagave për A.K.B. Janar-Shtator 2023; E-mail nga A.K. për ankesa.kpmshck@rksgov.net me numër protokollin 6375/2023 i datës 03.10.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar së ekziston baza ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën e ankueses

, sepe:

Bazuar në shkresat e lëndës konkretisht Ndryshimin e Aktit të Emërimit me numër protokollin 575 të datës 26.08.2023, rezulton se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës "Inspektore për Sigurimin e Aviacionit Civil", në kuadër të Departamentit për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme me koeficient të pagës tetë (8) sipas sistemit të vjetër të pagave.

Ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që ti rregullohet koeficienti i pagës sipas pozitës së punës, në pajtim me shtojcën 14.4 numri rendor 4 "ekspert 4" të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Mirëpo ankuesja më datë 03.10.2023 përmesë e-mailit ka bërë tërheqjen e ankesës së datës 19.09.2023 me arsyetimin se me datë 29.09.2023 ka pranuar përgjigje pozitive nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në rrethanat e lartcekura, konstaton se meqenëse ankuesja përmesë e-mailit të datës 03.10.2023 ka tërhequr ankesën e datës 19.09.2023, atëherë bazuar në dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt, administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1184/2023

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

